



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 146

16 nëntor

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.7818 datë 16.11.2012	Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë, të apelit dhe të gjykatave administrative, si dhe caktimin e kompetencave tokësore dhe selisë qendrore të gjykatave administrative	8089
Vendim i KM nr. 699, datë 10.10.2012	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Kala e Dodës të qarkut të Dibrës.....	8091
Vendim i KM nr. 737, datë 16.10.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.....	8092
Vendim i KM nr. 738, datë 16.10.2012	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Qendër Piskovë të qarkut të Gjirokastrës.....	8093
Vendim i KM nr. 739, datë 16.10.2012	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Kotë, të qarkut të Vlorës.....	8094
Vendim i KM nr. 742, datë 16.10.2012	Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit.....	8095

DEKRET
Nr.7818, datë 16.11.2012

**PËR CAKTIMIN E NUMRIT TË GJYQTARËVE PËR ÇDO GJYKATË TË SHKALLËS SË
PARË, TË APELIT DHE TË GJYKATAVE ADMINISTRATIVE, SI DHE CAKTIMIN E
KOMPETENCAVE TOKËSORE DHE SELISË QENDRORE TË GJYKATAVE
ADMINISTRATIVE**

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 4 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, me propozim të Ministrit të Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Në territorin e Republikës së Shqipërisë, numri i gjyqtarëve në gjykatat e rretheve gjyqësore është si më poshtë:

1. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, 10 gjyqtarë.
2. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, 4 gjyqtarë.
3. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, 17 gjyqtarë.
4. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, 14 gjyqtarë.
5. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, 14 gjyqtarë.
6. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, 6 gjyqtarë.
7. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, 4 gjyqtarë.
8. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, 14 gjyqtarë.
9. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, 4 gjyqtarë.
10. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, 4 gjyqtarë.
11. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, 4 gjyqtarë.
12. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, 5 gjyqtarë.
13. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, 5 gjyqtarë.
14. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, 4 gjyqtarë.
15. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet, 4 gjyqtarë.
16. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, 4 gjyqtarë.
17. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, 4 gjyqtarë.
18. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, 6 gjyqtarë.
19. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, 14 gjyqtarë.
20. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, 76 gjyqtarë.
21. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, 4 gjyqtarë.
22. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, 14 gjyqtarë.

Neni 2

Numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë është 16 gjyqtarë.



Neni 3

Në territorin e Republikës së Shqipërisë, numri i gjyqtarëve në gjykatat administrative të shkallës së parë është si më poshtë:

1. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, 16 gjyqtarë.
2. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, 4 gjyqtarë.
3. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, 4 gjyqtarë.
4. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, 4 gjyqtarë.
5. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë, 4 gjyqtarë.
6. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, 4 gjyqtarë.

Neni 4

Në territorin e Republikës së Shqipërisë, numri i gjyqtarëve në gjykatat e apelit është si më poshtë:

1. Në Gjykatën e Apelit Durrës, 13 gjyqtarë.
2. Në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, 6 gjyqtarë.
3. Në Gjykatën e Apelit Korçë, 6 gjyqtarë.
4. Në Gjykatën e Apelit Shkodër, 10 gjyqtarë.
5. Në Gjykatën e Apelit Tiranë, 31 gjyqtarë.
6. Në Gjykatën e Apelit Vlorë, 12 gjyqtarë.
7. Në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, 11 gjyqtarë.
8. Në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, 7 gjyqtarë.

Neni 5

Në territorin e Republikës së Shqipërisë, gjykatat administrative organizohen në 6 gjykata të shkallës së parë dhe 1 gjykatë apeli. 6 gjykatat administrative të shkallës së parë kanë kompetencë tokësore dhe seli qendrore të ushtrimit të veprimtarisë së tyre, si më poshtë:

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka kompetencë tokësore në rrethet: Bulqizë, Dibër, Krujë, Laç, Mat dhe Tiranë, me seli qendrore në Tiranë.
2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ka kompetencë tokësore në rrethet: Elbasan, Gramsh, Librazhd, Peqin, Durrës dhe Kavajë, me seli qendrore në Durrës.
3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka kompetencë tokësore në rrethet: Lezhë, Mirditë, Kukës, Has, Pukë, Malësi e Madhe, Shkodër dhe Tropojë, me seli qendrore në Shkodër.
4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka kompetencë tokësore në rrethet: Berat, Skrapar, Kuçovë, Fier, Mallakastër, Lushnjë dhe Vlorë me seli qendrore në Vlorë.
5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë ka kompetencë tokësore në rrethet: Devoll, Kolonjë, Bashkinë Leskovik, Korçë dhe Pogradec me seli qendrore në Korçë.
6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë ka kompetencë tokësore në rrethet: Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet, Delvinë dhe Sarandë, me seli qendrore në Gjirokastrë.
7. Gjykata Administrative e Apelit, me seli në Tiranë, ka kompetencë tokësore në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 6

1. Dekreti nr.6265, datë 16.09.2009 i Presidentit të Republikës “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë dhe të apelit” shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë për zbatimin e këtij dekreti.

Neni 7

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 699, datë 10.10.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS KALA E DODËS TË QARKUT TË DIBRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Kala e Dodës të qarkut të Dibrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 60 (gjashtëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 443 (katërqind e dyzet e tre).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Kala e Dodës, e qarkut të Dibrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Kala e Dodës Dibër

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-5, 211	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
6-7, 212	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
9, 11-12	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në përdorim



13-17, 19-20, 23, 387-413	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
50, 52, 54, 56, 58, 60, 62, 64, 342-352, 354-373, 375-386	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
51, 53, 55, 57, 59, 61, 63, 65	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
336-341	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim

VENDIM

Nr. 737, datë 16.10.2012

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 pika 3, 10 e 12 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Shtohet lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes, me numrat rendorë 1131 (një mijë e njëqind e tridhjetë e një) -1193 (një mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tre), që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Përmasat e pronave zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularët që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Lista përbëhet nga 312 (treqind e dymbëdhjetë) fletë.

II. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Mbrojtjes dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 738, datë 16.10.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS QENDËR PISKOVË TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të komunës Qendër Piskovë, të qarkut të Gjirokastrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 64 (gjashtëdhjetë e katër) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 470 (katërqind e shtatëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Qendër Piskovë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Qendër Piskovë

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-11, 13-24	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
27-31	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
32-47, 50-60, 62-67	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
48, 49, 61, 68-71, 76-80	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
72, 73	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
75	Prona që përdoren për shërbime sociale	Në pronësi
81-174, 175-184	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
186, 187	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
227, 229, 250, 252	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim



	Sip. 101 ha, zona kadastrale 2772 në fshatin Piskovë; sip. 40.3 ha, zona kadastrale 1292 në fshatin Bual, nuk transferohen pasi i janë dorëzuar AKKP-së	
262, 263, 269, 270	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi

VENDIM
Nr. 739, datë 16.10.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS KOTË, TË QARKUT TË VLORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Kotë të qarkut të Vlorës, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Kotë, të qarkut të Vlorës, miratuar me vendimin nr. 311, datë 18.3.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Kotë, të qarkut të Vlorës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Kotë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Kotë, Vlorë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
113-116	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
117-132	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
133-137	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
138-150	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore	Në pronësi

154-163	Varrezat publike	Në pronësi
164-173, 176	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
174-175	Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
177-205	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
241-245, 247-251, 253-255, 257-261, 263-267, 269-272, 274-278, 280-283, 285-289, 291-295	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim Nuk transferohet Sip. 233 ha, ZK 2245 fshati Kotë, pasi nga DAMT-ja e qarkut Vlorë dhe komuna Kotë i është dorëzuar AKKP-së.
246, 252, 256, 262, 268, 273, 279, 284, 290, 296	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
362-386, 388, 390-397	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
409-437	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
152, 153	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shërbimit social	Në pronësi

VENDIM
Nr. 742, datë 16.10.2012

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS KOMBËTARE TË KËRKIM-SHPËTIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 88 të ligjit nr. 10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nënndarjes “iii” të shkronjës “ç” të pikës 2 dhe të pikës 3 të nenit 32 të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të pikës 2 të nenit 5 e të pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr. 10 435, datë 23.6.2011 “Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- I. Statusi i Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit (QKSSH)**
1. Ngritjen e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit të Republikës së Shqipërisë, si person juridik publik, në varësi të Ministrit të Mbrojtjes, me seli në Tiranë.
 2. Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit është institucion qendror dhe ka stemën, logon dhe vulën e saj, të cilat miratohen nga Ministri i Mbrojtjes.
 3. QKSSH-ja është përgjegjëse për planizimin, organizimin, koordinimin dhe kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.



4. QKKSH-ja e zhvillon veprimtarinë e saj në mbështetje dhe në zbatim të Kushtetutës, të legjislacionit shqiptar për shërbimin e kërkim-shpëtimit dhe të konventave e marrëveshjeve ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.

II. Organizimi i Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit

1. Kryetari i QKKSH-së drejton veprimtarinë e kësaj qendre, në përputhje me këtë vendim dhe me kërkesat e ligjit nr. 10 435, datë 23.6.2011 “Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë”.

2. Kryetari i QKKSH-së, në funksion të ushtrimit të detyrave të veta, nxjerr urdhra dhe udhëzime.

3. Emërimi, lirimi ose shkarkimi nga detyra të kryetarit të QKKSH-së bëhet nga Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Koordinatorit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit (KKKSH).

4. Emërimi, lirimi ose shkarkimi nga detyra i personelit civil dhe ushtarak të kësaj qendre bëhet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes ose me urdhër të kryetarit të QKKSH-së, kur i është deleguar një kompetencë e tillë.

5. Marrëdhëniet juridike të punës të punonjësve civilë të QKKSH-së rregullohen nga Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, ndërsa për personelin ushtarak të QKKSH-së do të zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi për marrëdhëniet e punës së ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

III. Organizimi financiar i Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit

1. QKKSH-ja është institucion buxhetor dhe buxheti i saj është pjesë e buxhetit vjetor të Ministrisë së Mbrojtjes.

2. QKKSH-ja mund të marrë dhurime dhe financime nga organizma, brenda dhe jashtë vendit, për të cilat nuk ka detyrimin për t'i kthyer e që hyjnë në buxhetin e qendrës e përdoren në përputhje me destinacionin e dhënë.

3. Fondi për kërkim-shpëtimit, i krijuar në Agjencinë Nacionale të Trafikut Ajror si rezultat i kërkesave të Eurokontrollit, të derdhet çdo muaj në llogarinë e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit.

IV. Linja e komandimit dhe e kontrollit në Shërbimin e Kërkim-Shpëtimit

1. QKKSH-ja koordinon në nivelin më të lartë kombëtar operacionet e kërkim-shpëtimit në hapësirën tokësore, detare e në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë.

2. QKKSH-ja e ushtron aktivitetin e saj operacional nëpërmjet këtyre strukturave vartëse:

a) Qendrës Kombëtare Ajrore të Kërkim-Shpëtimit (QKAKSH);

b) Qendrës Kombëtare Detare të Kërkim-Shpëtimit (QKDKSH);

c) Strukturave të tjera të vendosura në varësi operacionale sipas Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit.

3. QKKSH-ja për nevoja të punës së saj, kur autorizohet nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, shfrytëzon edhe kapacitetet e Qendrës së Bashkuar Operacionale.

V. Mënyrat dhe procedurat e operimit të sistemit

1. QKKSH-ja e operon sistemin e kërkim-shpëtimit nëpërmjet strukturave të përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 2 të kreut IV të këtij vendimi.

2. Mënyrat dhe procedurat e operimit të sistemit janë ato të përcaktuara në manualët përkatëse të Shërbimit të Kërkim-Shpëtimit dhe në Planin Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit.

VI. Detyrat dhe përgjegjësitë e QKKSH-së

1. QKKSH-ja, përveç detyrave kryesore të përcaktuara me ligj, ka dhe këto detyra e përgjegjësi specifike:

a) përgatitjen e Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit;

b) planifikimin e nevojave dhe kërkesave për mjete, materiale, pajisje në interes të realizimit të planeve të kërkim-shpëtimit;

c) përgatitjen e procedurave standarde operacionale për marrjen, grumbullimin, shkëmbimin dhe vlerësimin e informacionit në interes të operacioneve të kërkim-shpëtimit;

ç) menaxhimin e informacionit të prodhuar nga QKAKSH-ja dhe QKDKSH-ja;

d) mbikëqyrjen e aktivitetit të Shërbimit të Kërkim-Shpëtimit;

dh) propozimin për miratim të tabelës së organizimit dhe të pajisjeve të Ministri i Mbrojtjes;

e) vendosjen në dispozicion të QKAKSH-së dhe QKDKSH-së të të gjitha aseteve të nevojshme për realizimin e operacioneve të kërkim-shpëtimit;

ë) përgatitjen dhe shpërndarjen e planeve, direktivave vepruese, procedurave dhe normave për trajnimin e strukturave përgjegjëse për të gjitha llojet e operacioneve të kërkim-shpëtimit;

f) marrjen e vendimeve dhe aktivizimin sipas fushës së përgjegjësisë të koordinatorëve dhe njësisë kombëtare SAR për ndërhyrje, kryerje dhe ndërprerje të operacioneve të kërkim-shpëtimit.

2. Kryetari i QKKSH-së i propozon për miratim Ministrin të Mbrojtjes vendin e vendosjes, objektin dhe infrastrukturën e përshtatshme për personelin, pajisjet dhe instalimet e tjera të nevojshme, në përmbushje të misionit të QKKSH-së.

VII. Detyrat dhe përgjegjësitë e Koordinatorit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit

1. Koordinatori Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit është shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

2. Koordinatori Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit ka këto detyra e përgjegjësi:

a) koordinon punën për hartimin e Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit;

b) mbikëqyr dhe kontrollon masat e marra në zbatim të Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit;

c) raporton të paktën një herë në vit dhe sa herë i kërkohet të Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit.

VIII. Bashkëpunimi

1. QKKSH-ja është pikë kombëtare kontakti për operacionet e kërkim-shpëtimit. Ajo bashkëvepron me institucionet shtetërore, entet private dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe përgjigjet për detyrimet kombëtare e ndërkombëtare në fushën e kërkim-shpëtimit në zonat e përgjegjësisë.

2. QKKSH-ja bashkëpunon me Drejtorinë e Emergjencave Civile për shfrytëzimin e kapaciteteve të deklaruara në Planin Kombëtar të Emergjencave Civile dhe shkëmbimin e informacioneve në raste të emergjencave civile dhe SAR.

IX. Dispozita të fundit

1. Vendimi nr. 3, datë 7.1.1999 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e shërbimit në fushën e kërkim-shpëtimit (SAR) të avionëve në rast aksidentesh ajrore” shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Koordinatori Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit dhe kryetari i Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 16.11.2012
Doli nga shtypi më 16.11.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 18 lekë